

NJOFTIM

Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë, bazuar në Urdhërin nr.10 datë 29.01.2024 të Rektorit, *shpall* njoftimin për konkurim të hapur, për vendin e lirë të punës në Universitetin “Ismail Qemali” Vlorë:

Personel administrativ me kohë të plotë, në pozicionin “Punonjës pastrimi/Sanitare”, pranë Sektorit të Shërbimeve, Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse, në Universitetin “Ismail Qemali” Vlorë.

Detyrat dhe përgjegjësitë

Të pastrojë dhe mirëmbajë nga ana higjeno-sanitare dhe funksionale sipërfaqet e ambjenteve të brendshme, të jashtme dhe të ambjenteve hidro-sanitare (tualetëve) që janë në administrim të Universitetit “Ismail Qemali”, Vlorë.

Kritere të përgjithshme që duhet të plotësoj/në kandidati/ët

- a) Të jetë shtetas/e shqiptar/e.
- b) Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur.
- c) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.
- d) Të jetë i aftë nga ana shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse.
- e) Të zotërojë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin e punës për të cilin konkurron;
- f) Të ketë aftësi të mira komunikuese etiko-profesionale, të bashkëpunimit dhe të punës në grup me kolegët dhe eprorët;
- g) Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë të Gjykatës për kryerjen e një vepre penale me dashje si dhe të mos jetë person nën hetim për vepra të rënda penale;
- h) Kandidati nuk duhet të ketë patur background negativ në eksperiencat e mëparshme në punë dhe të mos jenë marrë ndaj tij masë disiplinore “largim nga puna”;
- i) Të mos jetë në proces gjyqësor me Universitetin “Ismail Qemali” Vlorë;
- j) Të mos ketë vepruar ose propaganduar në drejtim të prishjes së imazhit të Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë dhe autoriteteve/organeve drejtuese të saj, në median vizive dhe/apo të shkruar, rrjetet sociale etj.

Kritere të veçanta

- Të ketë eksperiencë pune
- Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe koordinimi
- Të zotërojë minimalisht diplomë të arsimit bazë

Dokumentacioni i kërkuar

- a) Letër interesi për pozicionin (formulari i aplikimit gjendet në adresën www.univlora.edu.al)
- b) Jetëshkrim/ Curriculum Vitae;
- c) Diploma dhe lista e notave (kopje e noterizuar);
- d) Libreza e punës ose vërtetim zyrtar për periudhën kohore të punësimit nga organi tatimor (origjinal ose kopje të noterizuar);
- e) Referenca që provojnë vlerësimet pozitive në punë;
- f) Raport mjekësor për aftësinë në punë, lëshuar 3 muajt e fundit (origjinal);
- g) Vërtetim i gjëndjes gjyqësore (dokument i lëshuar nga Ministria e Drejtësisë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor dhe Prokuroria e Rrethit Gjyqësor ku kandidati ka vendbanimin);
- h) Letërnjoftimi ID (fotokopje);

Shënim:

Diplomat, çertifikatat, gradat dhe titujt e fituar në institucione të huaja arsimore, të shoqërohen me çertifikatën e njehsimit, bazuar në nenin 92 të Ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë".

Mënyra e aplikimit

Dokumentat duhet të dorëzohen **vetëm nëpërmjet shërbimit postar** në adresën:



Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë.

Drejtoria e Komunikimit dhe e Burimeve Njerëzore.

Aplikim për punësim/pozicioni i punës: "Punonjës pastrimi/Sanitare" pranë Sektorit të Shërbimeve në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse
Lagjja "Pavarësia", Rr. "Kosova" 9400 Vlorë, Shqipëri.

Afati për aplikim

- ✓ Afati për të aplikuar është 10 ditë kalendarike. Ky afat fillon nga dita e parë e shpalljes në faqen zyrtare të internetit të UV-së. (njoftimi u publikua në datën 29.01.2024 dhe afati përfundon në datën 07.02.2024).
- ✓ Dokumentacioni i dorëzuar në shërbimin postar pas datës 07.02.2024, do t'i kthehet aplikantit pa veprime.

Fazat në të cilën do të kalojë konkurimi

- ✓ Konkurimi do të kryhet në dy faza: vlerësimi i dosjes dhe intervista e drejtëpërdrejtë e kandidatit.
 - vlerësimi i dosjes parashikon verifikimin e dokumentave nëse kandidatët plotësojnë kushtet dhe kërkesat për vendin vakant, vlerësimin e arsimit, përvojës në punë, trajnimet e kualifikimet e lidhura me fushën përkatëse si dhe vlerësimet pozitive;
 - intervista e strukturuar me gojë;

Fusha e njohurive, aftësitë dhe cilësitë që do të vlerësohen në intervistë

- Aftësitë komunikuese, bashkëpunuese etj.

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve

Struktura e ndarjes së pikëve të vlerësimit të kandidatëve, është si më poshtë vijon:

- 70 pikë për vlerësimin e dokumentacionit të dorëzuar, e ndarë në: 30 pikë arsimimi, 20 pikë përvojë pune, 10 pikë për trajnime apo kualifikime të lidhura me fushën përkatëse, 10 pikë për vlerësimet e rezultateve individuale në punë.
- 30 pikë intervista e strukturuar me gojë, ku, me një grup të njëjtë pyetjesh për të gjithë kandidatët, vlerësohen njohuritë, aftësitë dhe formimi i tyre.

Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët

Komunikimi dhe njoftimi i kandidatëve do të mundësohet nga zyra e burimeve njerëzore të UV-së nëpërmjet postës elektronike.

DREJTOR

ELOINA TOZAJ